



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.:713/25 Datë:20.06.2025

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/I-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimi Administrativ (MASHTI) Nr. 01B-03/2024 për vlerësimin e përshtatshmërisë së bartësve të programeve, Rregullorja (AKA) Nr. 04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Bachelor dhe Master, Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe procesverbalit të mbledhjes 138 të mbajtur më 16.06.2025, mori:

V E N D I M

- I.** Akreditohet programi i studimit të Kolegjit AAB për periudhën tre (3) vjeçare,
(1 tetor 2025 – 30 shtator 2028):
 1. *Programim dhe Inteligjence Artificiale, BP (180 ECTS) me kuotën maksimumi 125 studentë për vit akademik.*
- II.** Riakreditohen programet e studimit të Kolegjit AAB për periudhën tre (3) vjeçare,
(1 tetor 2025 – 30 shtator 2028):
 2. *Kulture Fizike dhe Sport, MA (60 ECTS) me kuotën maksimumi 40 studentë për vit akademik;*
 3. *Kulture Fizike dhe Sport, BA (240 ECTS) me kuotën maksimumi 100 studentë për vit akademik;*
 4. *Produksion Medial, BP (180 ECTS) me kuotën maksimumi 50 studentë për vit akademik;*
 5. *Pikturë dhe Arte Vizuele, BA (180 ECTS) me kuotën maksimumi 25 studentë për vit akademik;*
- III.** Riakreditohen programet e studimeve të Kolegjit AAB për periudhën pesë (5) vjeçare,
(1 tetor 2025 – 30 shtator 2030):
 6. *Gjuhe Angleze, BA (180 ECTS) me kuotën maksimumi 250 studentë për vit akademik.*
- IV.** Numri i studentëve vlen dhe zbatohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- V.** Obligohet Kolegji AAB që deri më datë 30.09.2025 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- VI.** Obligohet Kolegji AAB të raportojë dhe arsyetojë çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Ndryshimi i bartësve bëhet vetëm me vendim nga KShC.
- VII.** Institucioni i Arsimit të Lartë mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.
- VIII.** Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Kolegji AAB brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për akreditimin dhe riakreditimin e programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>Programim dhe Inteligjence Artificiale, BP (180 ECTS)</i>	Lauresha Ramadani Samir Jakupi Leron Berisha Nida Santuri Fishekqiu Sherif Sheremetaj
2.	<i>Kulture Fizike dhe Sport, MA (60 ECTS)</i>	Blerim Sylejmani
3.	<i>Kulture Fizike dhe Sport, BA (240 ECTS)</i>	Fatmir Pireva Shemsedin Vehapi Zenel Metaj Shkelzen Shala Nazim Myrtaj
4.	<i>Produksion Medial, BP (180 ECTS)</i>	Kushtrim Koliqi Zija Rexhepi Ilir Tafa Valon Jakupaj
5.	<i>Pikturë dhe Arte Vizuele, BA (180 ECTS)</i>	Fitim Aliu Dita Ethem Roni Shishko
6.	<i>Gjuhe Angleze, BA (180 ECTS)</i>	Aida Alla Mirvan Xhemajli Aleksandar Takovski Fatmir Ramadani Bujar Rushiti

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Kolegjin AAB.

Bazuar në nenin 16 të Rregullores (AKA) Nr.03/2024 për procedurat e përzgjedhjes, angazhimit dhe kompensimit të ekspertëve të jashtëm dhe Rregulloren (AKA) Nr.04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Bachelori dhe Master (tutje Manualit), ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtarë) ka hartuar raportet e vlerësimit për këtë program dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

1. **Për programin e studimit; Programim dhe Inteligjence Artificiale, BP (180 ECTS)**, vizita me ekspertin ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më datë 14.03.2025 me këtë përbërje: Ahmad Zargari, Flavio Canavero dhe Laura Palac. Ekipi i ekspertëve ndërkombëtar ka konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush:
 - Plotësisht tri (3) fusha të standardeve të akreditimit;
 - Substancialisht katër (4) fusha të standardeve të akreditimit.
2. **Për programin e studimit; Kulture Fizike dhe Sport, MA (60 ECTS)** vizita me ekspertin ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më datë 03.04.2025 me këtë përbërje: Chris Richter, Snjezana Schuster dhe Lali Giorgidze. Ekipi i ekspertëve ndërkombëtar ka konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush:
 - Plotësisht tri (3) fusha të standardeve të akreditimit;
 - Substancialisht katër (4) fusha të standardeve të akreditimit.
3. **Për programin e studimit; Kulture Fizike dhe Sport, BA** vizita me ekspertin ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më datë 03.04.2025 me këtë përbërje: Chris Richter, Snjezana Schuster dhe Lali Giorgidze. Ekipi i ekspertëve ndërkombëtar ka konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush:
 - Plotësisht tri (3) fusha të standardeve të akreditimit;
 - Substancialisht katër (4) fusha të standardeve të akreditimit.
4. **Për programin e studimit; Produksion Medial, BP (180 ECTS)**, vizita me ekspertin ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më datë 15.04.2025 me këtë përbërje: Peter Purg, Ana Vivoda dhe Nino Alavidze. Ekipi i ekspertëve ndërkombëtar ka konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush:
 - Plotësisht tri (3) fusha të standardeve të akreditimit;
 - Substancialisht tri (3) fusha të standardeve të akreditimit.
 - Pjesërisht një (1) fusha të standardeve të akreditimit.
5. **Për programin e studimit; Pikturë dhe Arte Vizuale, BA (180 ECTS)** vizita me ekspertin ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më datë 15.04.2025. Ekipi i ekspertëve ndërkombëtar ka konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush:
 - Plotësisht dy (2) fusha të standardeve të akreditimit;
 - Substancialisht katër (4) fusha të standardeve të akreditimit.
 - Pjesërisht një (1) fusha të standardeve të akreditimit.
6. **Për programin e studimit; Gjuhë Angleze, BA (180 ECTS)** vizita me ekspertin ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më datë 23.04.2025 me këtë përbërje: Thomas Wulstan, Tanja Gradecak dhe Elissa Knief. Ekipi i ekspertëve ndërkombëtar ka konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush Plotësisht të shtatë (7) fushat e standardeve të akreditimit.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 138-të, të mbajtur më datë 16.06.2025, ka shqyrtuar dokumentacionin e Kolegjit AAB dhe duke u bazuar në raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave si dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtroj ankesë në Komisionin e ankesave të AKA, sipas paragrafit 11 të nenit 22 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga dita kur pala është njoftuar për vendimin e KShC-së. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.



Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit AAB;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së,